**z. Arben Limanaj:** vendimi për ndërtimin e kësaj çerdheje është shumë i qëlluar. Ne si grup kuvendar e mbështesim si vendim vetëm se duhet të na sqarohet nëse bëhet fjalë për parcelën që është në oborrin e shkollës “Motrat Qirazi” ? nëse është fjala për atë parcelë ne , në Kuvend kemi marr vendim që në atë parcelë të ndërtohet një shkollë e re. Ai projekt ish dashtë të realizohet pasi që është dorëzuar në ministri. Nëse behët fjalë për të njëjtën parcele gjithmonë e kam fjalën.

**z. Besnik Marku, drejtor i Kadastrit:** Përshëndetje të gjithëve. Po bëhet fjalë për të njëjtën parcelë por mbrapa është planifikuar hapësira prej 30 ari që të ndërtohet çerdhja e fëmijëve.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Hyrja e çerdhes është nga salla sportive dhe nuk e pengon aspak ndërtimin e ardhshëm të shkollës fillore. Është e njëjta parcelë me numër por ne i kemi bashkangjitur dokumentacionin dhe specifikun se ku do të ndërtohet çerdhja pa e penguar aspak projektin e ndërtimit të shkollës fillore.

**z. Zafer Gashi:** Është mirë të kemi kujdes sepse gjatë fushatës e kam dëgjuar kryetarin të ketë premtuar se në lagjen “Arbëria” do të ndërtohet një çerdhe e fëmijëve. Pas stacionit të policisë, prona është e komunës dhe është mese e sigurt nga vërshimet ndërtimi i një çerdhe e re e fëmijëve.

**z. Zenun Elezaj, kryetar Komune:** Përshëndetje për të gjithë. Ka qenë e destinuar për lagjen “Arbëria” ajo çerdhe që në fillim por në pamundësi për të gjetur pronë publike jemi detyruar që ta zhvendosim aty ku po flitet tani. Unë diji që nuk kemi prona aty por do ta verifikojmë. Kemi nevojë edhe për çerdhe tjetër. E kemi humbur një rast që të përfitojmë donacion ndërtimin e një çerdheje në lagjen “Dukagjini” pikërisht sepse s` kemi pasur prona publike në atë pjesë, mos ta humbim edhe këtë rast tani. Do të kemi nevojë vazhdimisht për ndërtimin e çerdheve të reja dhe në të ardhmen pasi ta verifikojmë pronësinë në pjesën ku theksuat ju, do të aplikojmë në fonde e donatorë.

**Me 20 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.**

**Pika 8 e Rendit të ditës: Interpelanca me kryetarin e komunës për qeverisjen 9-të mujore , thirrur nga LVV.**

Në fillim të kësaj interpelance fjalën e morri z. Zafer Gashi nga LVV si thirrës i kësaj interpelance.

**z. Zafer Gashi:** Qëllimi ynë nuk është që të bëjmë kundërshtime vetëm sepse jemi opozitë por që të ballafaqojmë argumentet në lidhje me zhvillimet dhe realizimin e projekteve të planifikuara, saktësisht mos realizimit të më shumë se sa 75% të projekteve të mos realizuara për vitin 2022. Edhe një herë e falënderoj kryetarin që



është gati për këtë interpelancë dhe e ftoj që të na informoj për të arriturat në realizimin e planifikimeve për këtë periudhë kohore.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Unë jam fokusuar në përgatitjen e një lloj raportimi për realizimin e programin qeverisës duke u bazuar në dokumentet e miratuara në Kuvend për projektet e planifikuara për implementim. Do të jap një gjendje të datës 31 Tetor, që është gjendje financiare e cila është edhe e aprovuar nga niveli qendror. Me gjithë vështirësitë që na ka sjell ky vit, mund të them që muajve të fundit kemi arritur me një intezitet më të lart që të përmbushim realizimin e projekteve. Sipas të dhënave të prokurimit i kemi proceduar të gjitha projektet e planifikuara për vitin 2022 dhe pothuajse të gjitha kontratat janë nënshkruar. Disa kontrata kanë qenë dy vjeçare. Ndërsa një projekt që është projekti për ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve nuk kemi arritë pasi që kemi mungesë të lokacionit. Ka qenë planifikuar në zonën e dukagjinit duke u bazuar në dokumentet ekzistues kur kemi premtuar por tani më ajo është anuluar nga qeveria. Kemi bërë kërkesë për marrjen e asaj zone dhe jemi në procedurë të privatizimit dhe marrjes së asaj zone. Me hartat zonale shtëpia [për të moshuar është planifikuar tek liqeni akumulues për ujë të pijes por procedurat për shpronësim zgjasin gjithsesi. Në këtë kuptim të gjitha projektet janë realizuar përveç këtij projekti. Deri me 31 tetor 2022 kemi pasur të hyra 1 milion e 755 mijë euro, shpenzimet kanë qenë 8 milion e 125 mijë. Tek kategoria e investimeve kapitale, shpenzimet janë 1 milion e 439 mijë euro. Kemi qenë në një % jo të mirë duke u bazuar me vonesat që na kanë shoqëruar gjatë vitit me rritjet e çmimeve, kontratat e mbetura pa u përmbushur nga OE shkaku i kësaj , në shtator shkëputja e kontratave dhe procedurat e reja etj. Sipas të dhënave të drejtorisë së Urbanizmit, nga gjithsejtë 2 milion 983, e 46 euro, ku 1 milion 47 mijë janë nga grandit 10 , grand qeveritar, 582 mijë e 265 euro janë nga të hyrat vetanake dhe 930 mijë e 666 euro janë të hyrat vetanake të bartura nga vitit 2021. Prej tyre pra janë shpenzuar 1 milion e 755 mijë euro ose 58.84% tek investimet kapitale. Me mirë se sa kjo % jemi tek drejtoritë e tjera por ne duhet të arrijmë mbi 75%. Kjo vlerë duhet të arrihet sepse janë kryer shumë projekte por janë në fazën e pranimit teknik. Shpresoj që do ta arrijmë këtë kriter të përfitimit të grandit të performancës. Për fat të mirë Komuna e Klinës është një nga 6-të komunat prej 38 që do të jetë përfituese. Edhe një të dhënë nga financat në total, shpenzimet totale nga të gjitha drejtoritë për investimet kapitale janë 2 milion e 127 mijë e 808 euro. Kjo e dhënë e nxjerrë sot nga drejtoria e financave. Nëse jeni të interesuar për ndonjë projekt specifik jemi të gatshëm të plotësojmë.

**z. Zafer Gashi:** Faleminderit kryetar. Raporti i GAP ka treguar se Komuna e Klinës është larg përmbushjes së premtimeve. Transparenca le shumë për të dëshiruar. P.sh. zyra e prokurimit- keni lidhë kontratë jashtëligjshëm me personin që ka dalë në pension, e i cili ka pasur probleme edhe me ligj e ka qenë nëpër gjykata. Kur të kam pyetur unë keni thënë se ju ka vazhduar shkaku u përvojës së tij dhe kur ju kanë pyetur në media se a e keni ditur që zyrtari në fjalë ka qenë i akuzuar, ju jeni përgjigjur që se keni ditur. Zyra e personelit- shpallë konkurse, pranohen me nga dy

familjarë etj. etj. Shpallni konkurs dhe e falsifikoni atë, ju e dini punën e drejtorit të QKMF-së së zgjedhur. Jeni i vetmi kryetar i komunës që ju është dashur që të thirrni njësi policore që të intervenojnë në zyrën tuaj për të i hequr qytetarët e Gremnikut shkaku i Fabrikës së Çimentos. Konkretisht sa biznese te grave i ke ndihmuar? Shëndetësia- sigurimi i aparatit mamografik, ku është ai aparat?

z. Gashi kishte vërejtje edhe në drejtorinë e arsimit, punësimet në këtë drejtori, drejtorinë e financave konkretisht tek të hyrat, tek inkasomi i të hyrave. Kishte vërejtje tek dhënia e lejeve për terasave dhe inkasomi i të hyrave nga këto hapësira. Inspektorati i ka dhënë leje punës operatorit i cili ka marr me qira objektin nga një person që atij ja ka dhënë me qira komuna. Më thoni zoti kryetar cilat pajisje i keni blerë për AMF-të. , theksoi zoti Zafer Gashi duke dashur që të vazhdonte edhe më tutje që sipas tij ka shumë të gjetura të tjera, si në Bujqësi e cila ka shpërnda trupa kumbullash e lajthish e nuk din se kujt ja ka ndarë. Z. Gashi foli edhe për mjetet e ndara për dekorim të qytetit 50 mijë euro e që është deklaruar se ato pajisje janë të mbetura nga vitet e kaluara dhe ruhen në sallë të sportit...

Kryesuesi duke theksuar se është tejkualuar shumë koha e planifikuar dhe e rregulluar sipas rregullores për fjalën e thirrësit të interpelancës ja morri fjalën z. Zafer Gashi. Që të kyçen në këtë debat kërkuan edhe z. Esat Raci dhe Valmir Bacaj. Por kryesuesi theksoi se të drejtën e ka për ta përmbyllur kryetari i Komunës sipas rregullores.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Tani z. Zafer Gashi foli dhe ngriti shumë çështje që e pata të pamundur që ti mbaj shënim nga forma që ai praktikoj për të prezantuar. Krejt ato që fliten nga z. Zafer besoj që janë dëshira të tij. Ekzekutivi vazhdon të punojnë në të mirë të qytetarëve. Ai është mësuar që ta përmend emrin tim, le ta përmend sa të dojë në çfarëdo konteksti, ndërsa ne jemi duke u angazhuar maksimalisht për të implementuar programin qeverisës. Sot puna e jonë është komplet e monitoruar nga niveli qendror. Sa i përket Ujërave të zeza, Zafi duhet ta dijë që nuk ka kapacitete Komuna për të ndërtuar impiant të ujërave të zeza, 10 milion euro, atë mund ta bëjë niveli qendror me të cilin nuk ka munguar përpjekja e jonë për të gjetë bashkëpunim. Njëjtë edhe për ujin e pijes, Komuna e ka kryer obligimin e vet karshi memorandum bashkëpunimit me ministrinë por që ata nuk i janë përmbajtur nënshkrimit të tyre dhe nuk kanë zotuar akoma mjetet prej 600 mijë eurove , të cilat mjete i kanë zotuar në 2021 dhe nuk i kanë zotuar në 2022. Komuna do ta kryej këtë projekt nga të hyrat vetanake në fund të fundit. Unë do të vazhdoj të kërkoj bashkëpunim me çdo instancë të këtij vendi që sa më mirë të ju shërbejmë qytetarëve të Komunës.

Fjalën e kërkoj për përfundim përsëri z. Zafer Gashi por sipas kryesuesit interpelanca përfundon me fjalën përmbyllëse të kryetarit të Komunës.

**Pika 9 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje**

**z. Esat Raci:** Pyetjen që e bëra në fillim të këtij sesioni. Konkursin që e keni shpallur për kulturë dhe ju është kthyer në pikën zero nga këshilli për ankesa i nivelit qendror. Pse ju është kthyer në zero ky konkurs? A është në pyetje komisioni vlerësues që nuk ka qenë në rregull? Nëse po, atëherë çfarë të bëhet me gjitha të punësuarit nga fundi i 2021 e deri tani po nga ky komision. Dhe pyetja e dytë: Kryetar keni premtuar çerdhe dhe shkollë në lagjen “Dukagjini”, sot e dëgjuam që në atë lagje nuk ka hapësirë publike për ndërtim. A e ka ditur në kohën e zgjedhjeve kur e ka bërë këtë premtim?

**z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës:** Përshëndetje. Sa për sqarim nuk është anuluar konkursi por është kërkuar nga ne që të plotësojmë komisionin. Është kërkuar nga ne që të formohet një komision ku përfshihen të gjithë shefat e sektorëve por që ndryshon varësisht nga sektori ku mbahet intervista. Për konkursin në fjalë kemi vendimin e këshillit të pavarur ku thotë se komisioni duhet të ketë një zyrtar nga zyra e personelit. Tani e kemi plotësuar komisionin në fjalë dhe na është pranuar nga Ministria e punëve të brendshme dhe sistemi. Intervista është caktuar të mbahet me datë 6 dhjetor. Pra nuk është përsëritë konkursi por është kërkuar që të vazhdohet me plotësime.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Në programin qeverisës timin asnjëherë nuk e kam përmendur shkollën në lagjen “Dukagjini”. Çerdhen dhe shtëpinë e pleqve po por unë e shpjegoja se me vendimi i 2019 ja ka dhënë në shfrytëzim Komunës dhe ka sugjeruar për bartjen e pronësisë të asaj sipërfaqe por këtë vit qeveria e ka anuluar atë vendim dhe na e ka marrë atë pronë . Tani do të shohim procedurat e privatizimit të asaj prone.

**z. Esat Raci:** Për përgjigjen e parë , ok . Dihet kush punësohet, të gjithë e dimë kush punësohet në Komunë dy apo tre muaj më përpara. I urojmë punësimin aktivitetit të LVV për atë vend të punës. Ndërsa sa i përket pyetjes për kryetarin, unë nuk përmenda programin qeverisës të kryetarit por premtimin e tij elektoral.

**Znj. Arta Pantina:** Përshëndetje për të gjithë. Dëshiroj të pyes drejtorin e SHP. Në Gllarevë punimet e ujësjellësit janë ndërprerë dhe gropat e hapura janë bërë të rrezikshme për fëmijët që shkojnë në shkollë. Kur do të nis vazhdimi i punimeve të ujësjellësit në fshatin Gllarevë.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Përshëndetje. Po filloj nga pyetja e znj. Blerina Berisha të shtruar në seancën e kaluar ku unë kam munguar për ta lidhur me pyetjen e znj. Pantina tani. Projekti në Gllarevë e diji që është stopuar shkaku i motit dhe vërshimeve në komunën tonë. Projekti është pothuajse në përfundim, ka mbetur vetëm instalimi i pompave në Jarinë dhe Ujmirë dhe trafo në këto dy vende. Besoi se deri në fund të muajit do të përfundojnë këto punime. Për sajimin e gropave presim që të nënshkruajmë kontratë me OE vitin e ardhshëm pasi që ka skaduar kontrata e më hershme.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Për gropat e hapura dhe të mbetura ashtu në fshatin Gllarevë, Kompania që është kontraktuar nga CDI e ka për detyrë që ta kthej terrenin ku janë bërë punimet në gjendjen e më parshme. Ne morëm shënim nga zonja Pantina dhe Inspektorati do të dalë në vend që ta konstatoi dhe ndërhyjë gjithsesi.

**Znj. Besiana Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Kam një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë. Kemi informata që mjekët punojnë në orët e kujdestarisë dhe nuk paguhen , Po ashtu kemi informata që mjete ka për pagesë, ku po shkojnë këto mjete?

**z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë:** Orët shtesë ose orët kujdestarie paguhet atëherë kur tejkalohe orët shtesë. Kjo është e rregulluar me ligj. Sa për informim për këto orë shtesë që e tejkalojnë numrin e orëve që e parasheh ligji paguhen rreth 2000 euro në muaj. Një detaj tjetër, ju e dini kontrata kolektive për punëtorët e shëndetësisë është anuluar nga një zëvendësministër dhe kjo nga data 1 dhjetor na paraqet probleme të tjera sepse neve na duhet që tani të bëjmë kalkulimet në bazë të ligjit të punës. Disa beneficione hiqen që ishin të parapara me kontratë kolektive pasi që tani do të na duhet të përmbahemi vetëm në ligjin e punës.

**z. Arben Limanaj:** Unë kam një pyetje për drejtorin e DKA. Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse mungon edhe pse është muaji dhjetor.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Besoi se ky problem ka qenë gjithandej Kosovës pasi që ka pasur probleme shkakut i çmimeve të rritura nga inflacioni. Tek ne furnizimi me pelet ka përfunduar ndërsa kemi pasur pak problem me furnizim me dru. Kjo është në procedurë të tenderimit dhe shumë shpejt do të përfundoj. Njëherë për njëherë nuk kemi mungesa në asnjë shkollë.

**z. Azdren Ramadani:** Ka më shumë se dy javë që ndriçimi publik në sheshin “Faruk Elezi” Nuk funksionon. Banorët dhe bizneset në këtë shesh ankohen për mungesë të ndriçimit.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Nuk besoj që janë dy javë që mungon ndriçimi. Kam kaluar andej, ndoshta një apo dy ditë ka munguar.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Sigurisht që do ta shohin nëse sot është funksionalizuar ndriçimi. Do të shikohet nga menaxheri i kontratës dhe do të ndërhyhet.

**Znj. Marigona Racaj:** Përshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e arsimit. A është e vërtetë që mësimdhënësit e shkollës fillore “Motrat Qiriazit” kanë shkuar në shëtitje në Shqipëri duke humbur një ditë pune. A është marr pëlqimi nga drejtorja e arsimit për këtë shëtitje?

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Po është e vërtetë që shkolla ka vepruar ashtu. Dita e shkollës ka qenë të dielën dhe ata kanë vazhduar duke bërë një pauzë dhe bërë një shëtitje. Për mos lajmërim ju është shqiptuar vërejtje drejtorit të shkollës.

**Znj. Valmira Krasniqi:** Kam një pyetje për kryetarin dhe për drejtorin e SHP. Me 7 dhjetor 2020 përmes një postimi në FB i ka informuar qytetarët se Komuna e Klinës së bashku me qeverinë Zvicerane ka filluar ndërtimin e ujësjellësit për 20 fshatra ku është edhe fshati Perqevë. Banorët e këtij fshati thonë se nuk është investuar asgjë për ujë të pijshëm. Shpimet që janë bërë në këtë fshat, një banor pyet nëse shpimet janë bërë për të hulumtuar ujë të pijshëm apo nëse mund të ketë material për prodhimin e çimentos?

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Projektin e CDi e kemi shpjeguar disa herë. Fati i Perqevës është fati i njëjtë me projektin që sipas zotimeve të CDi do të përfundoj këtë vit. Uji do të shkoj në Perqevë. E dyta, po më vjen keq që po bini pre e këtyre thash e thënave. Unë do të ju përgjigjem korrekt. Aty shpimet janë bërë për të hulumtuar nëse ka ujë sepse për ujë ka pasur nevojë fshati. Në gjuhën e shkencës thuhet se Hulumtimet kur bëhen edhe nëse nuk zbulohet ajo që dëshirojmë prap është sukses sepse e dimë të kundërtën.

**z. Zafer Gashi:** Pyetja ime është për kryetarin. Rezultatet po shihen. Po ju them sinqerisht se ajo që është bërë në zgjedhjet e fundit ka qenë fatkeqësi. A mund të na jepni një përgjigje konkrete- a keni qenë pro apo kundër fabrikës së çimentos në vitin 2017. Pyetja tjetër pranimi i kuadrit në shkollën e mesme profesionale "Fehmi Agani" a është kryer sipas ligjit? A janë pranuar tre persona apo dy?

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** veprimet e mija unë i kam marrë sipas kohës dhe kjo është çështje ndërlidhet me punën profesionale. Në vitin 1988 si student i magjistrature në Zagreb kam bërë analizën e parë të mergeles dhe kam sjellë rezultat se ajo lëndë e parë mund të përdoret për prodhimin e çimentos. Proceset e tjera janë transparente dhe unë punoj dhe veproj sipas pozitës që kamë. Pra, në librat e mija që janë libra të respektuara mund të i gjeshe këto analiza, që donë me i lexuar ti jap.

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Çdo konkurs hapet në bazë të ligjeve dhe udhëzimeve administrative dhe i nënshtrohet procedurave ligjore. Për procedurat e konkursit në fjalë në shkollën e mesme profesionale "Fahmi Agani" në Klinë, pas publikimit të rezultateve definitive, kandidatët e pakënaqur kanë pasur të drejtë ankese në afat prej 8 ditëve. Komisioni i ankesave pas shqyrtimit të lëndëve ankuese ka ardhur në përfundim se njëri nga tre kandidatet e përzgjedhur nuk i plotëson kushtet dhe kriteret dhe i njëjti komision e ka anuluar pozitën e tretë në atë konkurs. Pozita e njëjtë është shpallur prap në konkurs të rregullt dhe është në proces të zhvillimit.

**z. Zafer Gashi:** Njëri nga kandidatët që është pranuar e ka një konfirmim nga fakulteti i mjekësisë që është i diplomuar. A mjafton ai konfirmim apo duhet me pas diplomën gjithsesi?

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP:** Dua vetëm që të sqaroj z. Zafer Gashi se projekti prej 50 mijë euro për ndriçim dekorues është projekt tre vjeçar.

Pas përfundimit të sqarimit të fundit nga drejtori i SHP , kryesuesi konstaton se nuk ka të tjerë anëtarë të kuvendit që dëshirojnë të bëjnë pyetje. Kjo pikë e Rendit të Ditës ishte pika e fundit prandaj kryesuesi duke falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë e shpallë të mbyllur këtë mbledhje të kuvendit.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesues:

Fadil Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA KLINË  
MUNICIPALITY OF KLINA  
Nr. 052-41663/22  
Data 12.12.2022  
Klinë-Klina



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

## RAPORT VJETOR

### KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022

Parimi kryesor i KKSBB-së gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë kryesisht i përqendrimi në aktivitete për çështje të sigurisë në bashkëpunim me policinë dhe qytetarët, si dhe me forumet, organizatat tjera të sigurisë, KLSP-të, dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

KKSBB-ja, ka pasur si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Klinës.

**Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, gjatë vitit 2022 janë realizuar në këto data dhe janë trajtuar këto çështje:**

**1. Takimi i parë, më 05.05.2022, me pesë pika të rendit të ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Prezantimi i planit të KKSBB-së për vitin 2022,
3. Siguria në Komunën e Klinës,
4. Situata e krijuar pas pandemisë Covid-19 në komunë,
5. Të ndryshme.

**2. Takimi i dytë, më 07.07.2022, me katër pika të rendit të ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Siguria në shkollat fillore dhe të mesme, parapërgatitje për shtator,
3. Sensibilizimi i të rinjve për mbrojtje nga dukuritë negative,
4. Të ndryshme.

3. Takimi i tretë, më 26.09.2022, me katër pika të rendit të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Siguria në Komunën e Klinës,
3. Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore,
4. Të ndryshme.

4. Takimi i katërt, më 31.10.2022, me katër pika të rendit të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Siguria në Komunën e Klinës,
3. Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda,
4. Të ndryshme.

5. Takimi i pestë, më 29.11.2022, me tri pika të rendit të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Raportimi për gjendjen e sigurisë në Komunën e Klinës,
3. Të ndryshme.

6. Ndërsa takimi i gjashtë do të mbahet më 29.12.2022.

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit të KKSB-së për vitin 2022, dinamika e punës për vitin 2022, miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura, çështjet e sigurisë në komunën e Klinës, çështjet e arsimit në institucionet shkollore dhe parashkollore, pajisjet me kamera aty ku ka qenë e nevojshme në shkolla dhe rrugë, mbrojtja dhe rreziku nga zjarrvëniet, ndriçimi në



hapësirat publike, qentë endacakë, masat parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit etj.

Takimet e KKSBS-së, janë kryesuar nga nënkryetarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Selmanaj, e cila pas propozimit të rendit të ditës, është marrë me vërejtjet, sugjerimet, kërkesat dhe ankesat e të gjithë anëtarëve të KKSBS-së, si dhe zgjedhjen e tyre në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive përkatëse.

Komandanti i policisë, ka raportuar në çdo takim për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Klinës. Bashkëpunimi i policisë me komunën, anëtarët e KKSBS-së si dhe me qytetarët, ka qenë në nivel shumë të lartë. Përfaqësuesit e bashkësive fetare, kanë qenë bashkëpunues sa i përket sigurisë nga ana e policisë së Kosovës, si dhe nga ana e komunës së Klinës, për bashkëpunim dhe zgjidhjen e kërkesave të parashtruara. Ka pasur diskutime të ndryshme nga të gjithë anëtarët e KKSBS-së, FSK-së, përfaqësues nga Këshilli i prindërve dhe OJQ-ve për probleme të ndryshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Klinës.

Në takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga OSB-ja, KFOR-i dhe FSK-ja.

Të gjitha diskutimet, vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSBS-së, janë diskutuar, shqyrtuar nga përfaqësues kompetent të organeve komunale.

### **Rezultatet e arritura nga takimet e KKSBS-së për vitin raportues 2022**

-Institucionet komunale, kanë arritur që të realizojnë ndriçimin në shumë rrugë e lagje të planifikuara. Në disa pjesë të qytetit janë ndërmarrë masa nga Drejtoria përkatëse për rregullimin e ndriçimit në ato zona ku kishte probleme.

-Kanë filluar t'i vendosin shenjat të komunikacionit aty ku kanë munguar, aty ku kanë qenë të vendosura gabim.

-Masa të ndërmarra nga policia e Kosovës dhe Inspektorët, ndaj të gjithë atyre të cilët kanë rrezikuar sigurinë publike në forma të ndryshme, komunikacion, vjedhje, zjarrvënie etj.

-Kemi marr informacione nga anëtarët e KKSBS-së për probleme të ndryshme dhe me Drejtoritë përkatëse ju kemi dal në ndihmë.

-Policia e Kosovës, së bashku me institucionet komunale, janë angazhuar për bashkatdhetarët të cilët janë kthyer për pushime në vendlindje, që të shërbehen më lehtë dhe më shpejtë me shërbime komunale, sigurinë etj.

-Ka përfunduar vendosja e kamerave në të gjitha shkollat dhe disa pjesë të qytetit.

-Marrja e masave të duhura parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit.

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur të gjitha takimet e rregullta të KKSB-së.  
Takimi i fundit është i paraparë të mbahet në fund të këtij muaji, të gjitha materialet për mbajtjen e takimeve u janë dorëzuar me kohë anëtarëve dhe pjesëmarrësve të cilët kanë qenë të ftuar në takime.

Zv. Kryesuese,  
Marqë Selmanaj





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë  
Komiteti për Politik dhe Financa  
01Nr 06-41690 /22

Klinë: 12, 12, 2022

PËR: Kuvendin e Komunës së Klinës

Nga: Komiteti për Politik dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit Fadil Gashi



**REKOMANDIMET: e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 08.12.2022**

Komiteti për Politik dhe Financa në mbledhjen e X-të të rregullt për vitin 2022, shqyrtoj dhe rekomandoj për kuvend këto pika të rendit të ditës:

**1. Pika. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit dhe kalendari i mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2023**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi theksoj se mbledhjet e kuvendit janë paraparë të mbahen të premtën e fundit në çdo muaj, përveç muajit gusht i cili parashihet pushim dhe muajit dhjetor për shkak të festave të fundvitit, ndërsa mbledhjet e komiteteve tjera janë paraparë sipas afateve por në dit dhe data të ndryshme.

**Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që plani i punës së Kuvendit, komiteteve dhe kalendari të mbledhjeve për vitin 2023 të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 2. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Tetor-Nëntor.**

**Kërkesa 1.**

Kërkesë e parashtruar nga K. K. i cili thekson se vuan nga një sëmundje e rënd, gjithashtu thekson se ka probleme të tjera shëndetësore, me këtë rast kërkon ndihmë financiare pasi që duhet të kryej një kontroll në spitalin "Acibadem" në Turqi.

**Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e parashtruar nga K. K. për ndihmë financiare të dërgohet në zyrën e kryetarit dhe t'i ndihmohet sipas mundësive buxhetore.**

#### **Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit sipas kërkesës së A. G. i cili kërkon që të merret vendim dhe të ndryshohet Harta Zonale, pasi që rruga e planifikuar në parcelën Nr. 0004-17 ZK Dresnik është planifikuar gabim duke devijuar nga rruga kryesore.

**Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës nga DUMM rekomandoj që kërkesa të merret parasysh nga Drejtoria në fjalë me rastin e revidimit të Hartave Zonale, pasi që nuk mund të ndryshohet Harta Zonale me një kërkesë, andaj duhet pritur deri në revidimin e Hartës Zonale.**

#### **Kërkesa 3.**

**Kërkesë e Parashtruar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi, për shqyrtimin e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023**

-Sa i përket kësaj kërkesë referoj Drejtori për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi z. Besnik Marku, theksoj se kjo listë është përpiluar me kujdes nga drejtoria në bashkëpunim me ekzekutivin duke marrë parasysh interesin e përgjithshëm publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës, andaj kërkoj që të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në kuvend, ndërsa procedurat tjera do të zhvillohen konform ligjit Nr. 06/L-092.

**Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoj që kërkesa e parashtruar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të kaloj për shqyrtim dhe miratim në kuvend.**

#### **Kërkesa 4.**

Kërkesë e parashtruar nga S. G. nga fshati Sferk, veteran u UÇK-së, baba i pesë fëmijëve, kërkon ndihmë financiare pasi që thekson se vuan nga një sëmundje e rënd dhe se shpenzimet janë të pa përballueshme pasi që pritet edhe të operohet. Shuma e cila kërkon për trajtimin e sëmundjes është 500-1000 euro.

**Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e parashtruar nga S. G. për ndihmë financiare të dërgohet në zyrën e kryetarit dhe t'i ndihmohet sipas mundësive buxhetore.**